



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU – BASIC COURT OF PRIZREN
DEGA NË DRAGASH – OGRANAK U DRAGAŠU – DRAGASH BRANCH

C.nr.102/17

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – DEGA NË DRAGASH, si gjykatë e shkallës së parë, nga gjyqtarja Sabaheta Kurteshi, me sekretarën juridike Senida Nuri, në çështjen civile të paditësit H. S. nga fsh..., Komuna Dragash, të cilin me autorizim e përfaqëson av.A. H. nga G., kundër të paditurës Komuna e Dragashit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson I. R. nga Dragashi, lidhur me pagesën e shperblimit jubilar nga përvoja e punës, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor në prezencën e të autorizuarve të paleve, me dt. 21.12.2017 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. LAPROVOHET si e **BAZUAR** kërkespadija e paditësit H. S. nga fshati..., K. Dragash, **DETYROHET** e paditura Komuna e Dragashit – Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA), që paditësit t’i paguaj në emer të shperblimit për tri paga jubilarë, nga përvoja e punës, me rastin e shkuarjes në pension shumë e përgjithshme prej 1.764,00 € (njëmijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër euro) me kamat prej 8% duke llogaritur nga data e parshtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcenimin e përmbarimit të dhunshëm.

II. Me shpenzimet procedurale obligohet e paditura, dhe obligohet që paditësit t’ia paguaj shpenzimet procedurale në shumë prej 264 €.

A r s y e t i m

Paditësi H. S. nga fshati..., Komuna Dragash, përmes të autorizuarit të tij av.A. H., pranë kësaj gjykate ka parashtruar padinë, me të cilën ka kërkuar që ti bëhet pagesa në emer të shperblimit për tri paga jubilar nga pervoja e punës, me rastin e shkuarjes në pension, ndaj të paditurës si më lartë.

I autorizuari i paditësit si në padi dhe gjatë shqyrtimeve gjyqësore si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar: - mbetëm në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë së precizuar ashtu që i propozoj gjykatës që të merret për bazë kjo padi dhe t'ju behet pagesa në emer të shperblimit jubilar nga pervoja e punës – tri paga. Poashtu kam prit nga përfaqësuesit e të paditurës se padrejtësit e zgjatura me dekada ndaj kësaj kategorie të arsimit më në fund do të realizojnë këtë të drejtë. Sa i përket pretendimeve të përfaqësuesit të të paditurës, nuk e kundërshtojm faktin se me kontratën kolektive të arsimit të dt.18.04.2017, neni 35 par. 1 pika 8 kjart është paraparë paga jubilar e shperblimit nga pervoja e punës per 10,20,30 dhe 40 vite, mirëpo paditësit asnjëherë nuk i janë paguar, ndërsa kontrata kolektive e cila është e nënshkruar nuk ka paraparë saktësishtë për kohën e pagesës për arsimtaret dhe meqenëse të njëjtët nuk i kanë marr këto paga jubilar, sipas logjikës së thjeshtë duhet të kompensohen, aq më teper kur në tërë territorin e Kosovës, tani këto paga kanë filluar të paguhen. Si shembull kemi Aktgjykimin C.nr.110/17 të dt. 24.04.2017, nga Gjykata Themelore Dega në Suharekë, dhe i plotëfuqishëm me dt. 15.05.2017. Gjithashtu duke u nisur nga kjo bazë, i njëjti ka bërë precizimin e kërkesëpadisë dhe ka propozuar që për 10 vite pervojë pune ti paguhet vlera 50 % e 3 pagave bazë 470,00 € ashtu që shuma do të jetë 235,00 €, për 20 vite pervojë pune 75% të pagës bazë – 470,00€, ashtu që shuma duhet të jetë 354,00 €, për 30 vite pervojë pune 470,00€ (100%) dhe për 40 vite pervoj pune nga paga bazë duhet të jetë 150%, e që shuma është 705,00€, ashtu që shuma totale për pagesë për shperblimin jubilar nga pervoja e punës për paditësin duhet të jetë 1.764,00 €. Gjithashtu ka kërkuar edhe shpenzimet e procedures në shumën prej: per padi në shumën prej 104,00 €, për një seanc gjyqësore shumën prej 135,00€ dhe taksën gjyqësore prej 25 €, në shumën e përgjithshme prej 264,00 €.

Përfaqësuesi i të paditurës I. R. në pergjigje në padi, gjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën e tij të fundit deklaron: konkretisht në këtë lënd dhe ne rastet e tjera kete çështje e rregullon kontata e pergjithshme kolektive per arsim nr.013-2056 e dt. 18.04.2017 neni 35 i kësaj kontrate paragrafi 8 parasheh” Punëtoret anëtarët e sindikatës së arsimit, në vitet jubilar të punësimit përfitojnë shperblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit per 10 vjet në vlerë 50% në pagën bazë, per 20 vjet 75% për pagën bazë, per 30 vjet një pagë bazë, per 40 vjet 150% të pagës bazë. Shperblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi kur i punësuar ka plotësuar kushtet sipas kriterëve përkatëse”. Këto shperblime paguhen me 7 janar pas kalimit të pervojes 10 vjeqare në arsim. Thirrem në parashkrim dhe nuk kam të dhëna se a kan qenë anëtar të sindikatës se arsimit. Poashtu aktgjykimi i permendur sot nga ana e palës paditëse nuk mund të jetë burim i të drejtës sepse ne kemi burimin original dhe të drejtë e që është Kontrata Kolektive e Arsimit, e që në këtë rast kemi të bëjmë me një analizim të gabuar të këtij Aktgjykimi, sepse shperblimi jubilar paguhet kur kalohet pervoja e punës mbi 10 vite, ashtu që nëse njëri nga ta lëshon që të vërtetoj se ka pranuar këtë shperblim, kjo parashkruhet, e pas kalimit prej 20 viteve, prap ka të drejtën e shperblimit jubilar për 20 vjetorin, e këtu ka të bëjë me pervojën e punës, e jo me shumën e akumuluar gjatë jetës. Neni 35, par. 8 pika 6 parasheh momentin e pagesës së pervjetorit, e që kjo është 7 mars, menjëhere pas permbushjes së 10 viteve pervojë pune apo 20 vite pervojë pune.

Në rastin konkret meqenëse kjo kontratë nuk parasheh pagesat retroaktive, paditësi ka humbur dhe kjo do të thotë se paditësi nuk ka të drejtën në bazë të kësaj kontrate.

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike gjykata ka bërë administrimin e provave si në vijim: është bërë shiqimi në qarkullimin për llogari të dt. 07.12.2017, vërtetimi nr.44/2017, bëhet shiqimi në vendimin nr. 13-308/15 të dt.01.09.2015, kërkesa për kompensimin e tri pagave me nr. 10-120/08-18823 e dt.25.08.2017, bëhet shiqimi në Aktgjykimin C.nr.110/17 të dt. 24.04.2017, nga Gjykata Themelore dega në Suharekë, bëhet shiqimi në librezën e anëtarësisë së SBASHK-ut.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të paleve ndërgjyqëse dhe provave, e në kuptim të nenit 8 të LPK-ës, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar provat veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Nga shiqimi i Qarkullimit për llogari të dt. 07.12.2017, gjykata ka vërtetuar se paga bazë për tre muajt e fundit për paditësin H. S. ka qenë 471,09 €.

Nga leximi i vërtetimit nr.44/2017 të dt. 03.04.2017 gjykata vërteton se paditsi H. S. ka gjithsejt 39 vite, 7 muaj e 13 ditë përvoj pune si mësimdhënës në Skollen fillore të mesme të ulët "Fetah Sylejmani" në Dragash edhe atë duke filluar nga data 11.02.1972 e deri më datën 31.08.1972, pastaj nga data 05.09.1975 deri më datën 29.07.1976 dhe nga data 01.09.1977 deri më 31.08.2015

Nga shiqimi në vendimin mbi ndërprerjen e mardhënjës së punës nr. 13-308/15 të dt. 01.09.2015, gjykata vërteton faktin se paditësit H. S. i ndërpritet marrdhënja e punës për shkak se me dt. 30.08.2015 i ka plotësuar kushtet për pension të pleqërisë duke mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçe.

Nga leximi i kërkesës për kompensimin e tri pagave jubilarë me nr.10-120/08-18823 të dt. 25.08.2017 të paditësit drejtuar të paditurës Drejtorisë Komunale të Arsimit në Dragash, gjykata vërteton faktin se paditësi ka provuar realizimin e të drejtës në kompensimin e tri pagave jubilarë të përvojës së punës edhe në procedurë administrative.

Nga leximi i Aktgjykimit C.nr. 110/17 të dt. 24.02.2017 të Gjykatës Themelore Dega në Suharekë, shihet rasti nga praktika gjyqësore për shperblimin jubilar mbi përvojën e punës të vendosur nga kjo gjykatë.

Nga shiqimi librezën e anëtarësisë së SBASHK-ut vërtetohet anëtarësia e paditësit në këtë sindikat si dhe dëshmin se ka qenë anëtar i saj i rregullt.

Nga provat e administruara më lartë nuk është kontestuese fakti se paditësi ka qenë në mardhënjë pune tek e paditura DKA në Dragash, si mësimdhënës për mëse 40 vite, poashtu nuk është kontestues fakti se paditësi me dt. 30.08.2015 ka arritur moshën e pensionimit, pra ka mbushur moshën 65 vjet, por mbetet kontestues fakti se paditësit a i takon shperblimi jubilar me rastin e shkuarjes në pension nga përvoja e punës, e për të cilën çështje gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, për shkak se kjo kërkesë e paditësit është e rregulluar me dispozitat të Kontratës kolektive të arsimit në Kosovë e nënshkruar me dt. 18.04.2017, ku me dispozitat e nenit 35 pika 8 e kësaj kontrate përcakton të drejtën e tani ish të punësuarit në tri paga jubilarë, sipas mënyrës së vlerësimit e cila është përcaktuar me këtë kontratë.

Duke u bazuar në këto dispozitave materiale të cilat percaktojnë këto të drejta dhe detyrime për palet ndërgjyqëse dhe gjendjen faktike të vërtetuar, se paditësi ka punuar për rreth 40 vite tek e paditura e cila njëherit ka qenë edhe si pëndhënsja e tij e fundit, e i cili fakt nuk është kontestues, e që vërtetohet nga vertetimi i të paditurës, e poashtu edhe qarkullimin bankar të paditësit që e percakton pagën bazë të paditësit, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke aprovuar kërkesëpadin e paditësit me kamat ligjore prej 8 % duke llogaritur nga data e paraqitjes së padisë, e definuar sipas nenit 382 të LMD-së.

Sa i përket pretendimeve të pales së paditur në lidhje me parashkrimin e kërkesës për shperblimin jubilar, gjykata refuzoj këtë për faktin se një pretendim i tillë është i pabazuar dhe i pa argumentuar, e poashtu edhe faktit se sipas kontratës kolektive të cekur si më lartë në nenin 35 pika 8.5 të kësaj kontrate, detyrohet punëdhënësi që të paguaj shperblimin jubilar, kur i punësuari i ka plotësuar kushtet e shperblimit sipas kriterëve perkatëse, gjë që në rastin konkret pala e paditur ashtë dasht që sipas detyres zyrtare (ex officio) të permbush një obligim të tillë e të cilin obligim e njëjta nuk e ka permbush, gjë e cila vertetohet edhe nga kërkesa e pales paditëse drejtuar të paditurës, e cila gjendet në shkresat e lëndës.

Poashtu rreth parashkrimit për të cilin pala e paditur pretendon, është vetë dispozita e nenit 87 të Ligjit të Punës nr.03/L-2012, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/2010 ku parashihet se **“ te gjitha kërkesat nga marrëdhënja e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej 3 viteve nga dita e paraqitjes së kërkesës”**.

Prandaj rrjedhimisht me administrimin e provave të lartëtheksuara gjykata në këtë çështje ka vërtetuar se kërkesëpadia e paditësit për pagimin e tri pagave jubilarë në bazë të pervojës së punës është e bazuar, andaj bazuar në dispoziten e nenit 35 pika 8 e Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës si dhe nenit 87 të Ligjit të Punës gjykata aprovoj kërkesëpadin e paditësit dhe vendosi si në dispozitiv.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës me të cilën është detyruar e paditura t'i paguaj paditësit shumën prej 264,00 €, edhe atë për perpillimin e padisë shumën prej 104 €, 25 € per taksen për padi si dhe për një perfaqësim shumën prej 135 €, është e bazuar në nenin 449 të LPK-së si dhe tarifen e Odës së Avokatëve të Kosovës.

Nga të dhënat e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – DEGA DRAGASH

C.nr.102/17, dt. 21.12.2017

**Sekretarja juridike,
Senida Nuri**

**Gjyqtarja,
Sabaheta Kurteshi**

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afar prej 7 ditësh, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.